



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIJA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	2-010PK
Dep.	01-617/14
Nr. Ifaq.	
Broj stranica	02
Nr. pages	
Nr. Prot.	
Broj prot.	
Prot. No.	
Datum	20.02.2014
Date	
Datum	
Date	

PRISHTINE



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIJA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 24 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 13.02.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbylljet rasti me nr. AKK – 03-4410/13, për z. Adem Kafexholli – Drejtor i Departamentit “Nëna dhe Fëmi” në Spitalin e Prizrenit, për arsy se i njëjti ka shmangur situatën e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtimin e Funksionit Publik, nr. AKK – 03-4410/13, për zyrtarin e lartë z. Adem Kafexholli – Drejtor i Departamentit “Nëna dhe Fëmi” në Spitalin e Prizrenit, dhe njëkohësisht pronar në biznesin privat “OS Gjinekologjia”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtimin e Funksionit Publik.

Në këtë rast, zyrtari i lartë z. Kafexholli, fillimisht është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit lidhur me funksionin e tij publik.

Pas pranimit të kësaj shkresë, zyrtari në fjalë, është kontaktuar nga Agjencia dhe i është sqaruar situata në të cilën ndodhet. Ai ka konfirmuar se në cilësinë e zyrtarit të lartë ushton funksionin e Drejtorit të Departamentit “Nëna dhe Fëmi” në Spitalin e Prizrenit dhe se është pronar në biznesin privat “Gjinekologjia”.

Zyrtari i lartë publik ka kuptuar situatën e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, prandaj pas rekomandimit të Agjencisë, ka premtuar se do të autorizoj një person të besueshëm për të udhëhequr biznesin.

Ndërkohë, z. Kafexholli, ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03-419/14) në të cilën vërtetohet se i njëjtë ka autorizuar një person të besueshëm për ta udhëhequr biznesin e tij privat.

Prandaj, duke pasur parasysh këto të dhëna, konstatojmë se gjendja e mundshme e konfliktit të interesit është shmangur.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./zpj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

Hasan Preteni

